

Universiteti i Elbasanit organizon Javën e 2-të Ndërkombëtare "Kultura dhe Komunikimi" në kuadër të programit Erasmus+

Universiteti i Elbasanit përfundon me sukses Javën e 2-të Ndërkombëtare "Kultura dhe Komunikimi" në kuadër të programit Erasmus+

Gjatë datave 8-12 Maj në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvilluan një sërë aktivitete në kuadër të Javës Ndërkombëtare, ku pjesëmarrës nga universitetet partnere mundën të njihnin nga afër universitetin dhe qytetin e Elbasanit, të shkëmbenin njohuri dhe përvoja, si dhe të ndanin praktikën më të mirë.

Në këtë javë të veçantë, pjesëmarrësit u angazhuan në aktivitete të ndryshme si, seminare, ture kulturore, pjesëmarrje në Panairin UNIEL, ku mundën të njihnin nga afër traditën, gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare, si dhe të prezantohen me fakultetet, personelin dhe studentët tanë.

Ndërkombëtarizimi është një element themelor i misionit të Universitetit të Elbasanit dhe angazhimi i tij në përcaktimin e arsimit të lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Përmes këtij përkushtimi, universiteti siguron një mjedis të pasur akademik dhe shkencor, i cili kontribuon në formimin e studentëve dhe zhvillimin e një shoqërie të hapur ndaj botës.











